



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 6, Nenit 18 paragrafi 3, Nenit 24 dhe Nenit 32 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, (Ligji Nr. 03/L-043);
- Kërkesën për shtyrje afati të licencës për gjenerim të energjisë elektrike për TC Kosova A, e datës 19.05.2014;
- Njoftimin për aplikim për marrjen e Lejes Mjedisore të Integruar, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me Nr. Prot: 1464/14, të datës 30.04.2014; dhe
- Aplikacionin për vazhdim të licencës për prodhim të energjisë elektrike të datës 19.05.2014 të ndërmarrjes Korporata Energjetike e Kosovës –Divizioni i Gjenerimit “KEK SH.A.”-TC Kosova “A”, adresa: rruga “Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 03 tetor 2014, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **I VAZHDOHET** licenca për prodhim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës – Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.)-TC Kosova A, me numër licence ZRRE/Li_05/13_A, për periudhën nga **04 tetor 2014** deri **04 tetor 2015**.
- II. **Obligohet** KEK SH.A. që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të këtij vendimi të sigurojë Lejen Mjedisore të Integruar nga MMPH, dhe kopjen e së njëjtës ta dërgojë në ZRRE.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 19.05.2014 ka pranuar nga KEK SH.A Kërkesën për Vazhdim Licence për prodhim të energjisë elektrike të KEK Sh.a. – Divizioni i Gjenerimit”-TC Kosova “A” për periudhën nga 04.10.2014 deri me 04.10.2020.
- Me vendimet V_380_2011 të datës 30 shtator 2011, V_437_2012 të datës 01 tetor 2012, dhe V_556_2013 të datës 06 shtator 2013, Bordi i ZRRE-së i kishte vazhduar licencën për prodhim të energjisë elektrike KEK SH-A - TC Kosova A për periudhën nga 04 tetor 2011 deri 04 tetor 2012, 04 tetor 2012 deri 04 tetor 2013 respektivisht për periudhën 04 tetor 2013 deri 04 tetor 2014, duke obliguar të licencuarin që brenda periudhës së përcaktuar në pikën (I) të dispozitivit të këtyre Vendimeve, ta sigurojë nga MMPH Lejen Mjedisore të Integruar, dhe një kopje ta dërgojë në ZRRE.



- KEK SH.A për përmbushjen e dispozitave të licencës dhe po ashtu obligimit të përcaktuar në vendimet V_556_2013, me datë 27.03.2014 ka bërë “Kërkesë për Leje Mjedisore të Integruar” me nr. tprot. 1466/2014, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
- Në Njoftimit e MMPH-së të datës 30.04.2014 thuhet se: *MMPH ka pranuar aplikacionin për Leje Mjedisore të Integruar dhe është duke e shqyrtuar lëndën në bazë të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, (Ligji Nr. 03/L-043), ku Neni 11 i këtij ligji parasheh që të gjitha impiantet ekzistuese, në këtë rast KEK-u, duhet të harmonizohen me kërkesat që përcaktohen me dispozitat e këtij ligji jo më larg se 31 dhjetor 2017, duke marrë parasysh Planin e propozuar të Orarit të Përputhshmërisë për atë impiant. Duke u nisur nga fakti që zbatimi i dispozitave që dalin nga ligji i lartpërmendur kërkojnë një analizë të thellë të gjendjes teknike të instalimeve të KEK-ut, që paraqesin një kompleks të madh industrial por edhe me një vjetërsi të konsiderueshme, do të kërkohet një bashkëpunim i ngushtë me KEK-un për të planifikuar mirë kohën e plotësimit të kushteve për përmbushjen e standardeve të përcaktuara me legjislacionin për mjedis. Meqenëse është nxjerrë vendimi që TCA duhet të dekomisionohet nga viti 2017, Plani i propozuar i Orarit të Përputhshmërisë për atë impiant duhet të realizohet shumë më herët se viti 2017. Pas shqyrtimit të raportit dhe plotësimit të kushteve të parapara në Nenin 9 të Ligjit të lartpërmendur MMPH-ja do të lëshojë Vendimin për Leje Mjedisore të Integruar.*
- ZRRE duke marrë parasysh këtë që u tha më lartë, dëshmitë e bashkëngjitura aplikacionit për vazhdim licence dhe sipas dispozitave ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A)
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar